



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*

## “TRAJTIMI I PACIENTËVE ME SKIZOFRENI”

### UDHËRRËFYES KLINIK

Udhërrëfyesi Nr.22

Prishtinë, 2023

Verzioni 1.0

**Këshilli Kosovar për udhërrëfyes dhe protokole klinike:**

|                          |                   |
|--------------------------|-------------------|
| MSc. Niman Bardhi, PhDc. | Kryesues          |
| Dr. Teuta Qilerxhiu      | Anëtare           |
| Dr. Fakete Hoxha         | Anëtare           |
| Z. Mentor Sadiku         | Anëtar            |
| Znj. Fatbardha Murtezi   | Anëtare           |
| Prof.Dr. Lul Raka        | Anëtar            |
| Dr. Driton Vela          | Anëtar            |
| Dr. Albana Morina        | Anëtare           |
| Dr. Elton Bahtiri        | Anëtar            |
| Dr. Edmond Haliti        | Anëtar            |
| Z. Agron Bytyqi          | Anëtar            |
| Dr. Hajrullah Fejza      | Sekretari teknike |

**Komisioni për vlerësimin e metodologjisë së hartimit të Udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike:**

|                         |           |
|-------------------------|-----------|
| Prof.Dr. Merita Berisha | Kryesuese |
| Prof. Dr. Vlora Ibishi  | Anëtare   |
| Prof.Dr. Valbona Zhjeqi | Anëtare   |
| Dr. Merita Vuthaj       | Anëtare   |
| Dr. Drita Demiri        | Anëtare   |

**Sekretaria për procesin e zhvillimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike:**

|                          |          |
|--------------------------|----------|
| MSc. Niman Bardhi, PhDc. | Kryesues |
| Dr. Rina Hoxha           | Anëtare  |
| Znj. Zana Shabani        | Anëtare  |

**Grupi punues:**

|                       |           |
|-----------------------|-----------|
| Dr. Laura Shehu       | Kryesuese |
| Mr. Sci Ariana Qerimi | Anëtare   |
| Dr. Fitim Skeraj      | Anëtar    |
| Dr. Miftar Zenelaj    | Anëtar    |
| Dr. Naim Fanaj        | Anëtar    |
| Dr. Valbona Tafilaj   | Anëtare   |
| Mr.Ph. Sabit Kozmaqi  | Anëtar    |

# Përbajtja

|  |     |
|--|-----|
| I.Hyrje .....  | 4   |
| 1.1Qëllimi dhe fokusi .....                              | 5   |
| 1.2 Të dhënat për skizofrenin .....                      | 5   |
| 1.3 Popullata e synuar .....                             | 6   |
| 1.4 Dedikimi i udhërrëfyesit.....                        | 6   |
| 1.5 Pyetjet .....  | 6   |
| II.Metodologjia .....                                    | 7   |
| III.Përkufizimet.....                                    | 8   |
| IV. Menaxhimi i Skizofrenisë .....                       | 13  |
| 4.1 Vlerësimet Fizike dhe Laboratorike .....             | 15  |
| 4.2 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Planit të Trajtimit ..... | 17  |
| 4.3 Përdorimi i Matjeve Sasiore .....                    | 20  |
| 4.4 Elementet e Planit të Trajtimit.....                 | 20  |
| V.Trajtimi .....   | 22  |
| VI.Farmakoterapia - Medikamentet Antipsikotike.....      | 37  |
| VII. Standardet e Auditueshme .....                      | 63  |
| VIII.Aplikim dhe Zbatimi i UPK-së në rrithana tonë ..... | 63  |
| IX. Procesi i Adaptimit të Udhërrëfyesit .....           | 64  |
| X. Referenca .....                                       | 65  |
| XI. Shkurtësat.....                                      | 110 |
| XII.Shtojca.....   | 111 |

## I.Hyrje

Skizofrenia është një çrregullim mendor i karakterizuar me dëmtim në proceset e të menduarit, në reagim emocional, në përceptim dhe ndërveprim social.

Skizofrenia është një sëmundje serioze mendore që ndikon në mënyrën se si një person mendon, ndihet dhe sillet.

### Faktet kryesore<sup>1</sup>

- ❖ Sipas OBSh-së, Skizofrenia shkakton psikozë dhe shoqërohet me paaftësi të konsiderueshme dhe mund të prekë të gjitha fushat e jetës duke përfshirë funksionimin personal, familjar, social, arsimor dhe profesional.
- ❖ Stigma, diskriminimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut te personat me skizofreni janë të zakonshme.
- ❖ Më shumë se dy nga tre persona me psikozë në botë nuk marrin kujdes të specializuar për shëndetin mendor.
- ❖ Ekziston një sërë mundësish efektive të kujdesit për personat me skizofreni dhe së paku njëri nga tre persona me skizofreni mund të shërohet plotësisht.

**Skizofrenia** karakterizohet me dëmtime të konsiderueshme në mënyrën se si përceptohet realiteti dhe ndryshimet në sjellje që lidhen me:

- ❖ Deluzione të vazhdueshme: personi ka besime të fiksuar se diçka është e vërtetë, pavarësisht nga provat për të kundërtën;
- ❖ Halucinacione të vazhdueshme;
- ❖ Personi mund të dëgjojë, nuhasë, shohë, prekë ose ndjejë gjëra që nuk janë aty;
- ❖ Përvoja e ndikimit, kontrollit ose pasivitetit;
- ❖ Ndjenja që impulset, veprimet ose mendimet e dikujt nuk gjenerohen nga vetja, vendosen në mendjen e dikujt ose tërhiqen nga mendja, nga të tjerët, ose që mendimet e dikujt po transmetohen te të tjerët;
- ❖ Të menduarit e çorganizuar, që shpesh vërehet si fjalim i ngatërruar ose i parëndësishëm;
- ❖ Sjellja shumë e çorganizuar p.sh. personi bën gjëra që duken të çuditshme ose pa qëllim, ose personi ka përgjigje emocionale të paparashikueshme ose të papërshtatshme që ndërhyjnë në aftësinë e tij për të organizuar sjelljen e tyre.

“Simptomet negative,” të folurit shumë i kufizuar dhe shprehja e kufizuar e emocioneve, pamundësia për të përjetuar kënaqësinë dhe tërheqjen sociale; dhe ose agjitation ekstrem ose ngadalësim i lëvizjeve si dhe mbajtja e qëndrimeve të pazakonshme.

Personat me skizofreni hasin në vazhdimësi vështirësi me aftësitë e tyre njohëse ose të të menduarit, si kujtesa, vëmendja dhe zgjidhja e problemeve.

<sup>1</sup>OBSh [https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/schizophrenia#text=Schizophrenia%20affects%20approximately%2024%20million,as%20many%20other%20mental%20disorders](https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/schizophrenia)

Të paktën një e treta e personave me skizofreni përjetojnë lehtësim të plotë të simptomeve<sup>2</sup>. Disa persona me skizofreni përjetojnë përkeqësim dhe remision të simptomeve në mënyrë periodike gjatë gjithë jetës së tyre, të tjerë që karakterizohet me një përkeqësim gradual të simptomeve me kalimin e kohës.

## 1.1 Qëllimi dhe fokusi

Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është të përmirësojë cilësinë e kujdesit dhe rezultatet e trajtimit te pacientët me skizofreni.

Ky udhërrëfyes synon të ndihmojë mjekët, klinicistët, dhe profesionistët e shëndetit mendor në trajtimin e pacientëve, duke ofruar të dhëna të bazuara në prova që synojnë të rrisin njohuritë dhe të rrisin përdorimin e duhur të trajtimeve për skizofreninë.

Ky udhërrëfyes fokusohet në trajtimet farmakologjike dhe jofarmakologjike të bazuara në prova për skizofreninë.

Për më tepër, ai përfshinë të dhënat në lidhje me vlerësimin dhe planifikimin e trajtimit, të cilat janë pjesë përbërëse e kujdesit të përqëndruar te pacienti.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij udhërrëfyesi është të përmirësojë trajtimin e individëve të prekura nga skizofrenia, duke reduktuar kështu vdekshmérinë dhe sëmundshmérinë.

## 1.2 Të dhënat për skizofrenin

Sipas Statistikave globale skizofrenia prekë afërsisht 24 milionë persona ose 1 në 300 persona [0.32%] në mbarë botën.

Norma është 1 në 222 persona [0.45%] tek të rriturit<sup>3</sup>. Nuk është aq e zakonshme nëse krahasohet me çrregullime të tjera mendore.

Fillimi është më shpesh gjatë adoleshencës së vonë dhe te vitet e njëzeta, fillimi ka tendencë të ndodhë më herët tek meshkujt sesa tek femrat.

Rreth 4% deri në 10% e personave me skizofreni vdesin nga suicidi, ku përqindja më lartë është te meshkujt sidomos në fazën e hershme të çrregullimeve.

Personat me skizofreni kanë 2 deri në 3 herë më shumë gjasa të vdesin më herët se sa popullata e përgjithshme<sup>4</sup>. Kjo ndodhë për shkak të paraqitjeve të sëmundjeve kardiovaskulare, metabolike dhe infektive.

Ndërsa sa i përket vendit tonë, referuar të dhënavë të publikuara nga enti statistikor i Kosovës për numrin e përgjithshëm të populatës në Republikën e Kosovës si dhe referuar të dhënavë të dërguara nga Institucionet e Shëndetit Mendor<sup>5</sup> të zberthyera në %, norma është

<sup>2</sup> Harrison G, Hopper K, Craig T, Laska E, Siegel C, Wanderling J. Recovery from psychotic illness: a 15- and 25-year international follow-up study. Br J Psychiatry 2001;178:506-17.

<sup>3</sup> Institute of health Metrics and Evaluation (IHME). Global Health Data Exchange (GHDx). <http://ghdx.healthdata.org/gbd-results-tool?params=gbd-api-2019-permalink/27a7644e8ad28e739382d31e77589dd7> (Accessed 25 September 2021)

<sup>4</sup> Laursen TM, Nordentoft M, Mortensen PB. Excess early mortality in schizophrenia. Annual Review of Clinical Psychology, 2014;10, 425-438

<sup>5</sup> <http://www.instat.gov.al> › media › vjetari-statistiko.2018& Institucionet e Shëndetit Mendor 2023

0,61 % në popullatën e përgjithshme. Kjo statistik për skizofreni është e përafërt me statistikat e publikuara nga OBSh-ja.

### **1.3 Popullata e synuar**

Ky udhërrëfyes synon të përmirësojë trajtimin e skizofrenisë për individët e prekur, duke reduktuar kështu vdekshmërinë, sëmundshmërinë dhe pasojat e rëndësishme psikosociale dhe shëndetësore të kësaj gjendjeje të rëndësishme psikiatrike  
Popullata e synuar: janë adoleshentët, të rriturit dhe të moshuarit.

### **1.4 Dedikimi i udhërrëfyesit**

Ky udhërrëfyes u dedikohet të gjithë drejtuesve dhe profesionistëve shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit që ofrojnë shërbime shëndetësore për trajtimin e skizofrenisë.

### **1.5 Pyetjet**

- ❖ Çka është skizofrenia ?
- ❖ Cilat janë simptomet predominuese te skizofrenia ?
- ❖ Si bëhet menaxhimi i pacientëve me skizofreni në kujdesin parësor shëndetësor ?
- ❖ Cilat vlerësime sygjerohen për pacientët me skizofreni?
- ❖ Cili është plani i trajtimit?
- ❖ Cilat janë elementet e planit të trajtimit?
- ❖ Cilat janë intervenimet psikosociale?
- ❖ Si menaxhohen krizat e skizofrenisë ?
- ❖ Cilat janë modalitetet specifike të trajtimit farmakologjik dhe jo farmakologjik?

## **II. Metodologjia**

Ky udhërrëfyes është hartuar nga grupi punues multidiciplinar dhe multiprofesional i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë-Republika e Kosovës:

Të gjithë anëtarët e grupeve punues para hartimit të këtij udhërrëfyesi kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë konflikt interesit për çka edhe kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit. Ky udhërrëfyes është hartuar në përputhje me metodologjinë standarde të procesit të adaptimit të udhërrëfyesve duke u shërbyer me dokumentin AGREE II, dhe marrja e vendimeve dhe rekomandimeve nga anëtarët e grupeve punues është bërë me konsensus [me pëlqim të plotë të të gjithë anëtarëve të grupeve punues].

Grupi punues ka rishikuar udhërrëfyesët klinik të publikuar në vitet e fundit, me rekomandime të qëndrueshme dhe me shkallë të lartë të evidencave, gjithashtu grupi punues është referuar në statistikat më të reja.

Udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna në udhërrëfyesin klinik janë bazuar në literaturën ndërkombëtare si dhe përshkrimi i rekomandimeve është bërë sipas literaturës së përzgjedhur. Janë shqyrtuar shumë udhërrëfyes klinik praktik dhe përfundimisht grupi punues është përcaktuar për udhërrëfyesit në vijim:

- ❖ Practice Guideline for the Treatment of Patient with Schizophrenia Third Edition 2021, si dhe grupi punues është referuar në të dhënat më të reja të OBSh-së.
- ❖ WHO <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/schizophrenia>.

Metodologjia e përdorur në literaturën e përzgjedhur për adaptimin e udhërrëfyesit referohet në provat që mbështesin referencat: prova klinike të rastësishme, studime në të cilat përcillen subjektet gjatë gjithë kohës grupet e kontrollit dhe grupet e trajtimit.

Shumë nga studimet e përfshira në rishikimin sistematik kanë përfshirë individët me një diagnozë të çrregullimit skizoafektiv në mënyrë që të mundësojë hartimi i rekomandimeve unike për këtë grup pacientësh.

Përditësimi i këtij udhërrëfyesi do të bëhet pas tri-viteve, por gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e organizatave kredibile ndërkombëtare.

### **III.Përkufizimet**

**Aleanca terapeutike:** një karakteristikë e marrëdhënies midis pacientit dhe klinikistit që përshkruan ndjenjën e bashkëpunimit në ndjekjen e qëllimeve terapeutike, si dhe ndjenjën e lidhjes së pacientit me klinicistonin dhe përceptimin nëse klinicisti është i dobishëm [Gabbard 2009].

**Doza Adekuate:** nënkupton dozën e një medikamenti për paraqitjen e efekteve terapeutike.  
**Përgjigjia adekuate:** një reduktim i simptomeve si rezultat i trajtimit që shoqërohet me përfitime të rëndësishme klinikisht në funksionimin dhe/ose cilësinë e jetës. Një reduktim i simptomeve prej 50% ose më shumë përdoret ndonjëherë si një prag për përshtatshmërinë e përgjigjes.

**Deluzioni:** një besim i rremë i bazuar në konkluzionet e pasakta për realitetin e jashtëm që mbahet fort pavarësisht nga ajo që pothuajse të gjithë të tjerët besojnë dhe pavarësisht nga ajo që përbën provë ose provë të pakundërshtueshme dhe të dukshme për të kundërtën

**Halucinacioni** përvoja të ngjashme me perceptimin që ndodhin pa një stimulim të jashtëm. Halucinacionet janë të forta dhe të qarta, me forcën dhe ndikimin e plotë të perceptimeve normale dhe jo nën kontroll vullnetar. Ato mund të ndodhin në çdo modalitet ndijor/shqisor [American Psychiatric Association 2013a].

**Kapaciteti për vendimmarje:** një vendim specifik klinik ose i lidhur me trajtimin, "për të komunikuar një zgjedhje, për të kuptuar informacionin përkatës, për të vlerësuar pasojat mjekësore të situatës dhe pér të arsyetuar rreth zgjedhjeve të trajtimit" [Appelbaum 2007, f. 1835].

**Kundërindikimi:** një situatë në të cilën një medikament ose procedurë nuk duhet të përdoret sepse mund të jetë e dëmshme pér pacientin.

**Ide suicidale:** nënkupton mendime pér t'i shkaktuar vdekje vetvetës.

**Idetë suicidale** mund të ndryshojë në thellësin e seriozitetit në varësi të specifikës së planeve suicidale dhe shkallës së qëllimit suical.

**Impulsiviteti** Veprimi sipas nxitjes së momentit në përgjigje të stimujve të menjëhershëm, duke vepruar në baza momentale pa një plan ose pa marrë parasysh rezultatet, vështirësi në vendosjen dhe ndjekjen e planeve, ose të kesh një ndjenjë urgjencë dhe të shfaq sjellje vetëdëmtuese nën shqetësimin emocional [amerikane Shoqata Psikiatrike 2013f].

**Medikamente antipsikotike:** janë nga një grup medikamentesh që përdoren në trajtimin e psikozës.

**Mendimi i çorganizuar:** [i referuar edhe si çrregullimi formal i mendimit]. Individ mund të kalojë nga një temë në tjetrën [shkatërrim ose shoqërimë të lirshme], t'u japë përgjigje pyetjeve në një mënyrë të lidhur ngushtë ose krejtësisht të palidhur [tangjencialiteti], ose të shfaqë të folur të rëndë të çorganizuar dhe pothuajse të pakuptueshëm që i ngjan afazisë receptive në

çorganizimin e saj gjuhësor [jokoherenca ose "përzierje fjalësh"] [përshtatur nga Shoqata Amerikane e Psikiatrisë 2013a].

**Pashpresë:** nënkuptojmë ndjenjën e dëshpërimit për të ardhmen nga besimi se nuk ka mundësi për zgjidhje të problemeve aktuale ose të arritjes të një rezultati pozitiv.

**Plan trajtimi gjithëpërfshirës dhe i përqendruar te personi:** nënkupton një plan të trajtimit që zhvillohet si rezultat i vlerësimit psikiatrik dhe modifikohet sipas indikacioneve klinike.

Një plan trajtimi gjithëpërfshirës mund të përfshijë trajtime jofarmakologjike, trajtime farmakologjike ose të dyja. Ai është i individualizuar për paraqitjen klinike të pacientit, nevojat e lidhura me sigurinë, kushtet shoqëruese mjekësore, sfondin personal marrëdhëniet, rrethanat e jetës dhe pikat e forta dhe dobësitë.

**Përpjekje për suicid:** një sjellje jofatale ndaj vetës potencialisht dëmtuese me qëllim për të shkaktuar vdekur. Një përpjekje për vetëvrasje mund ose nuk mund të rezultojë në lëndim [Crosby et al. 2011]. Mund të ndërpritet nga individi ose të ndërpritet nga një individ tjetër. Një tentativë suicidale mund ose nuk mund të rezultojë me lëndim.

**Përpjekja e ndërprerë suicidale:** përkufizohet si sjellje potencialisht vetë-dëmtuese me dëshmi/fakte (eksplikite ose të nënkuptuara) se personi kishte ndërmend të vdiste por e ndaloi përpjekjen para se të ndodhë dëmtimi fizik.

**Plani suicidal:** përcaktimi i metodës, mjeteve, kohës, vendit ose detajeve të tjera për përfshirjen në sjellje dëmtuese të vetëshkaktuar me çdo qëllim për të vdekur si rezultat i sjelljes.

**Qëllimi për suicid:** nënkupton pritjen dhe dëshirën subjektive për një veprim vetëshkatërrues që përfundon me vdekje.

**Suicidi:** është vdekje e shkaktuar nga sjellja dëmtuese, e vetë-drejtuar me qëllim për të shkaktuar vdekjen.

**Sjellje motorike jashtëzakonisht e çorganizuar ose jonormale:** mund të shfaqet në mënyra të ndryshme, duke filluar nga "marrëzi" fëmijërore deri tek agitacioni i paparashikueshëm.

**Sjellja katatonike:** është një tjetër manifestim i sjelljes motorike jonormale dhe mund të variojë nga rezistenca deri te instruksionet [negativizmi], për të mbajtur një qëndrim të ngurtë, të papërshtatshëm ose të çuditshëm në mungesë të plotë të përgjigjeve verbale dhe motorike [mutizëm dhe hutim].

Mund të përfshijë gjithashtu aktivitet motorik pa qëllim dhe të tepruar pa shkak të dukshëm [eksitim katatonik].

**Simptomet negative:** Simptomet negative mund të janë të dukshme në skizofreni dhe mund të përfshijnë zvogëlimin e shprehjes emocionale [kontaktin me sy, intonacionin e të folurit, lëvizjet e duarve, kokës dhe fytyrës], uljen e aktiviteteve të motivuara të qëllimshme të vetë-inicuara [shmangia], reduktim e fjalive, të folurit e varfëruar ndikon në procesin e të menduarit që çon në mungesë të folurit shkakton dhe probleme me rrjedhshmërinë verbale.

**Simptomet pozitive:** janë mendime, perceptime ose veprime të gabuara që tregojnë se personi nuk mund të dallojë atë që është e vërtetë nga ajo që nuk është e vertetë, këto simptome mund të përfshijnë:

- **Haluciononet:** personat me skizofreni mund të dëgjojnë, shohin, nuhasin ose ndjejnë gjëra që askush tjetër nuk i bën, dhe mund të përfshijë shumicën e sferave përceptive si ato vizuele, auditive, taktile, ollfaktore.
- **Deluzionet:** janë besime të gabuara që duken të çuditshme për shumicën e personave, mund të janë persekutuese, referente, somatike, eromane, fetare dhe të madhështisë.
- **Mendime të ngatërruara dhe të folur të organizuar:** personat me skizofreni mund ta kenë të vështirë të organizojnë mendimet dhe të shprehurit e tyre.
- **Çrregullime e sjelljes:** disa persona me skizofreni mund të manifestojnë çrregullime të sjelljes, ndonjëherë ata bëjnë lëvizje të njëjtë pa pushim por ndonjëherë ato mund të janë krejtësisht të qeta për orë të tëra, gjë që ekspertët e quajnë si sjellje katatonike.

**Vlerësimi:** procesi i marrjes së informacionit për një pacient nëpërmjet metodave në vijim: intervistë ballë për ballë, rishikimi i të dhënavë mjekësore, ekzaminimi fizik [nga psikiatri, një mjek tjetër ose një klinicist i trajnuar mjekësor], testimi diagnostik, ose marrja e historisë nga burime tjera.

**Vlerësimi fillestare psikiatrik:** një vlerësim gjithëpërfshirës i një pacienti që ka synim të identifikojë arsyen që pacienti është paraqitur për vlerësim, të krijojë raporte me pacientin, të kuptojë sfondin e patientit, marrëdhëniet, rrëthanat aktuale të jetës dhe pikat e forta dhe dobësitë e tij, të vërtetojë nëse pacienti ka një gjendje psikiatrike, të grumbullojë informacionin e nevojshëm për të zhvilluar një diagnozë diferenciale dhe formulim klinik, t'i identifikojë shqetësimet e menjëherëshme për sigurinë e patientit.

Zhvilloni një plan fillestare trajtimi ose rishikoni një plan ekzistues në bashkëpunim me pacientin.

**Trauma:** Trauma është një përgjigje emocionale ndaj një ngjarjeje të tmerrshme si një aksident, përdhunim ose fatkeqësi natyrore. Menjëherë pas ngjarjes tronditja dhe mohimi janë manifestimet tipike për traumat.

Reagimet më afatgjata përfshijnë emocione të paparashikueshme, rikthime të prapambetura, marrëdhënie të tensionuara madje edhe simptome fizike si dhimbje koke ose vjellje.

Trauma mund të përfshijë gjithashtu fatkeqësi të hershme, neglizhencë, keqtrajtim, abuzim emocional, abuzim fizik ose abuzim seksual që ndodh në fëmijëri dhe në moshën e rritur si shkak i ekspozimi ndaj fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, ekspozimi ndaj situatave luftarake, të qenit viktimë e një krimi të dhunshëm, përfshirja në një aksident të rëndë automobilistik, ose të paturit e përvojave të rënda ose të dhimbshme ose të zgjatura mjekësore [p.sh. qëndrimi në njësinë e kujdesit intensiv].

## Përbajtja e Udhërrëfyesit

### Vlerësimi dhe Përcaktimi i Planit të Trajtimit

- ❖ APA rekomandon (1C) që vlerësimi fillestar i një pacienti me një çrregullim të mundshëm psikotik të përfshijë:
  - ❖ Arsyen që individi po paraqitet për vlerësim;
  - ❖ Qëllimet dhe preferencat e pacientit për trajtim;
  - ❖ Një rishikim të simptomeve psikiatrike dhe historisë së traumës;
  - ❖ Një vlerësim të përdorimit të duhanit dhe përdorimit të substancave të tjera;
  - ❖ Histori të trajtimit psikiatrik;
  - ❖ Një vlerësim të shëndetit fizik;
  - ❖ Një vlerësim të faktorëve psikosocial dhe kulturor;
  - ❖ Një ekzaminim të gjendjes mendore përfshirë vlerësimin kognitiv dhe një vlerësim të rrezikut për suicid dhe sjellje agresive, siç përshkruhet në Udhëzimet praktike të APA për Vlerësimin Psikiatrik të të Rriturve (botimi i 3-të).
- ❖ APA rekomandon (1C) që vlerësimi fillestar psikiatrik i një pacienti me një çrregullim të mundshëm psikotik të përfshijë një matje sasiore për të identifikuar dhe përcaktuar ashpërsinë e simptomeve dhe dëmtimet e funksionimit që mund të jenë fokus i trajtimit.
- ❖ APA rekomandon (1C) që pacientët me skizofreni të kenë një plan trajtimi të dokumentuar, gjithëpërfshirës dhe të përqëndruar te personi, i cili përfshinë trajtime jofarmakologjike dhe farmakologjike të bazuara në prova.

### Farmakoterapia

- ❖ APA rekomandon (1A) që pacientët me skizofreni të trajtohen me një mjekim antipsikotik dhe të monitorohen për efektivitetin dhe efektet anësore.\*
- ❖ APA rekomandon (1A) që pacientët me skizofreni, simptomet e të cilëve janë përmirësuar me një mjekim antipsikotik, të vazhdojnë të trajtohen me një mjekim antipsikotik.\*
- ❖ APA sugjeron (2B) që pacientët me skizofreni, simptomet e të cilëve janë përmirësuar me një mjekim antipsikotik të vazhdojnë të trajtohen me të njëjtin mjekim antipsikotik.\*
- ❖ APA rekomandon (1B) që pacientët me skizofreni rezistente ndaj trajtimit të trajtohen me klozapinë.\*
- ❖ APA rekomandon (1B) që pacientët me skizofreni të trajtohen me klozapinë nëse rreziku për tentativa suicidale ose suicid mbetet i konsiderueshëm pavarësisht trajtimeve të tjera.\*
- ❖ APA sygjeron (2C) që pacientët me skizofreni të trajtohen me klozapinë nëse rreziku për sjellje agresive mbetet i konsiderueshëm pavarësisht trajtimeve të tjera.\*

- ❖ APA sygjeron (2B) që pacientët të marrin trajtim me një mjekim antipsikotik injektues me veprim të gjatë nëse preferojnë një trajtim të tillë ose nëse kanë një histori aderimi të dobët ose të pasigurt.\*
- ❖ APA rekomandon (1C) që pacientët që kanë distoni akute të shoqëruar me terapi antipsikotike të trajtohen me një mjekim antikolinergjik.
- ❖ APA sygjeron (2C) opsonet e mëposhtme për pacientët që kanë parkinsonizëm të lidhur me terapinë antipsikotike: uljen e dozës së medikamentit antipsikotik, kalimin në një medikament tjeter antipsikotik ose trajtimin me një medikament antikolinergjik.

### Ndërhyrjet Psikosociale


APA rekomandon [1B] që pacientët me skizofreni që janë duke përjetuar një episod të parë të psikozës të trajtohet në mënyrë të koordinuar me kujdes të specializuar.\*

- ❖ APA rekomandon [1B] që pacientët me skizofreni të trajtohen me terapi kognitive-sjellëse për psikozën [TKSp/CBTp].\*
- ❖ APA rekomandon [1B] që pacientët me skizofreni të marrin psikoedukim.\*
- ❖ APA rekomandon [1B] që pacientët me skizofreni të marrin shërbimet e mbështetura të punësimit.\*
- ❖ APA rekomandon (1B) që pacientët me skizofreni të marrin trajtim në komunitet nëse ka një histori të angazhimit të dobët me shërbimet që çojnë në rikthim të shpeshtë ose ndërprerje sociale (p.sh., të pastrehët; vështirësi ligjore, duke përfshirë burgimin).\*
- ❖ APA sygjeron [2B] që pacientët me skizofreni që janë në kontakt të vazhdueshëm me familjen të marrin/pranojnë intrervenime nga familja.\*
- ❖ APA sygjeron [2C] që pacientët me skizofreni të synojnë zhvillimin e aftësive të vetë-menaxhimit, duke rritë-përmirësuar orientimin e personave\*
- ❖ APA sygjeron [2C] që pacientët me skizofreni të marrin rehabilitim kognitiv/njohës.\*
- ❖ APA sygjeron [2C] që pacientët me skizofreni të cilët kanë një qëllim terapeutik për përmirësimin e funksionimit social të marrin trajnime për aftësim social.\*
- ❖ APA sygjeron [2C] që pacientët me skizofreni të trajtohen me psikoterapi mbështetëse.\*

\* Kjo deklaratë udhëzuese duhet të zbatohet në kontekstin e një trajtimi të përqëndruar te personi, plan që përfshinë trajtime jofarmakologjike dhe farmakologjike të bazuara në dëshmi për skizofreninë.

## IV. Menaximi i Skizofrenisë

### Vlerësimi



**Antipsikotik me monitorim**

-Zgjidhni bazuar në:


- formulimet në dispozicion
- ndërveprimet dhe metabolizmi
- vitetë farmakokinetike
- profili i efekteve anësore

Monitoroni për:

- efekte anësore
- reagimi i simptomeve duke përfshirë jo ose përgjigje e pjesshme
- aderimi

Përmirësimi?

Çështje aderimi?



## 4.1 Vlerësimet Fizike dhe Laboratoriike

| Vlerësimi fizike [organike] dhe laboratoriike të sygjeruara për pacientët me Skizofreni          |   |   |
|--|---|---|
| Vlerësimi  | Fillestar/Bazë  | Përcellja/Follow -up  |
| <b>Vlerësimet për monitorimin e gjendjes fizike dhe zbulimin e rrethanave shoqëruuese fizike</b> |   |   |
| Shenjat vitale   | Pulsi, presioni i gjakut  | Pulsi, presioni i gjakut, temperatura e indikuar klinikisht   |
| Pesha trupore dhe gjatësia   | Pesha e trupit, gjatësia<br>Indeksi i masës trupore IMT   | IMT/BMI çdo vizitë për 6 muaj<br>dhe të paktën çdo tremuj më pas  |
| Hematologji  | TKS/CBT përfshirë<br>NAN/ANC  | TKS/CBC, duke përfshirë<br>NAN/ANC nëse indikohet klinikisht [d.m.th., pacientët e trajtuar me klozapinë] |
| Kimia e Gjakut   | Elektrolitet, testet e funksionit të veshkave, mëlcisë, testet e funksionit, TSH                                      | Sipas indikacionit klinik   |
| Shtatzënia   | Testi i shtatzanisë për gratë në moshën riprodhuese   |   |
| Toksikologjia  | Ekzaminimi i toksikologjisë së medikamenteve, nëse indikohet klinikisht   | Ekzaminimi i toksikologjisë së medikamenteve, nëse indikohet klinikisht                                   |
| Studime elektrofiziologjike  | EEG, nëse indikohet në bazë të ekzaminimit neurologjik ose historisë  |   |
| Imazh  | Imazhi i trurit [CT or MRI, me preferencë MRI], nëse indikohet në bazë të ekzaminimit neurologjik ose historisë       |   |
| Testimi gjenetik   | Testimi kromozomik, nëse indikohet në bazë të ekzaminimit fizik dhe historisë, duke përfshirë historinë e zhvillimit. |   |

**Vlerësimi fizike dhe laboratorike të sygjeruara për pacientët me Skizofreni /d**  
**Vlerësimi fizike [organike] dhe laboratorike të sygjeruara për pacientët me Skizofreni /d**

Vlerësimi

Fillestar/Bazë

Përcjellja/Follow -up

Vlerësimet në lidhje me efektet e tjera anësore specifike të trajtimit

|  |  |   |
|--|--|---|
| Diabeti <sup>f</sup>                                     | Depistimi për diabetin, faktorët e rrezikut <sup>f</sup> , agjërimi, glukoza në gjak   | Glukoza në gjak agjërimi ose hemoglobina A1C 4 muaj pas fillimit të një trajtimit të ri dhe të paktën çdo vit më pas  |
| Hiperlipidemia   | Paneli i lipideve  | Paneli i lipideve 4 muaj pas fillimit të një mjekimi me antipsikotik të ri dhe të paktën çdo vit pas kësaj  |
| Sindromi Metabolik                                       | Përcaktoni nëse sindromet metabolike, kriteret janë plotësuar  | Përcaktoni nëse kriteret e sindromës metabolike plotësohen, 4muaj pas fillimit të një mjekimi të ri antipsikotik dhe të paktën çdo vit pas kësaj  |
| Zgjatja/Prolongimi i QTc                                 | EKG para trajtimit me klorpromazin, droperidol, iloperidone, pimozid, tioridazine, ose ziprasidone ose në prani të faktorëve të rrezikut të zemrës.  | EKG me ndryshim të rëndësishëm në dozën e klorpromazinës, droperidol, iloperidone, pimozide, tioridazine, ose ziprasidone, ose me shtimin e medikamenteve të tjera që mund të ndikojnë në QTcintervali në pacientët me faktorë rreziku kardiak ose intervale të ngritura në bazë të QTc   |
| Hiperprolaktinemia                                       | Ekzaminimi për simptomet e hiperprolaktinemisë. Niveli i prolaktinës, nëse tregohet në bazë të historisë klinike   | Ekzaminimi për simptome të hiperprolaktinemisë në çdo vizitë derisa të jetë stabile, pastaj çdo vit nëse trajtohet me një antipsikotik që dihet se rrit nivelin e prolaktinës nëse indikohet në bazë të historisë klinike   |
| Çrregullimet e lëvizjes të shkaktuara nga antipsikotikët | Vlerësimi klinik i akatizisë, distonisë, parkinsonizmit dhe lëvizje të tjera jonormale të pavullnetshme, duke përfshirë diskinezin tardive. Vlerësimi me një instrument të strukturuar [p.sh., AIMS, DISCUS] nëse lëvizje të tillë janë të pranishme | Vlerësimi klinik i akatizisë, distonisë, parkinsonizmit dhe lëvizjeve të tjera jonormale të pavullnetshme, duke përfshirë diskinezinë tardive, në çdo vizitë Vlerësimi me një instrument të strukturuar [p.sh., AIMS, DISCUS] të paktën çdo 6 muaj te pacientët me rrezik të lartë të diskinezisë tardive dhe të paktën çdo 12 muaj në pacientë të tjërë gjithashtu sikur të jetë një fillim ose përkeqësim i ri i lëvizjeve paraekzistuese |

## **4.2 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Planit të Trajtitimit**

APA rekomandon [1C] që vlerësimi fillestar i një pacienti me një çrregullim të mundshëm psikotik të përfshijë:

- ❖ Arsyen pse individi po paraqitet për vlerësim;
- ❖ Synimet dhe preferencat e pacientit për trajtimin;
- ❖ Një rishikim të simptomeve psikiatrike dhe historisë së traumës;
- ❖ Një vlerësim të përdorimit të duhanit dhe substancave të tjera;
- ❖ Një histori trajtimi psikiatrik;
- ❖ Një vlerësim të gjendjes të shëndetit fizik;
- ❖ Një vlerësim të faktorëve psikosocial dhe kulturor
- ❖ Një ekzaminim i gjendjes mendore, duke përfshirë vlerësimin konjittiv dhe
- ❖ Një vlerësim të rrezikut për sjellje suicidale dhe sjellje agresive.

APA rekomandon [1C] që vlerësimi fillestar psikiatrik i një pacienti me një çrregullim të mundshëm psikotik të përfshijë një matje sasiore për të identifikuar dhe përcaktuar ashpërsinë e simptomeve dhe dëmtimeve të funksionimit që mund të jenë fokusi i trajtimit gjithashtu, rekomandon që pacientët me skizofreni të kenë një plan të trajtimit të dokumentuar, gjithëpërfshirës dhe të përqëndruar te personi që përfshinë trajtime jofarmakologjike dhe farmakologjike të bazuara në dëshmi.

### **Elementet që duhen marrë parasysh si pjesë e planit të trajtimit: Intervenimet farmakologjike**

- ❖ Psikoterapië dhe ndërhyrjet e tjera psikosociale;
- ❖ Mbështetje angazhuese;
- ❖ Aderim në trajtim;
- ❖ Adresim të rreziqeve për suicid/agresion;
- ❖ Adresimi të duhanit dhe SUD-ve’;
- ❖ Adresim të simptomeve, diagozave të tjera shoqëruese psikiatrike;
- ❖ Trajtimin e kushteve të tjera shoqëruese shëndetësore;
- ❖ Shqetësimet e shtatzënisi/pas lindjes;
- ❖ Vendosjen e trajtimit;
- ❖ Çështjet e trajtimit të pavullnetshëm;
- ❖ Nevojat e pacientëve në mjedise korrektuese.

## Aspektet e rekomanduara të vlerësimit fillestar psikiatrik

### **Historia e sëmundjes aktuale**

- ❖ Arsyja që pacienti po paraqitet për vlerësim, duke përfshirë simptomet aktuale, sjelljet dhe faktorët precipitues.
- ❖ Diagnozat aktuale psikiatrike dhe shqyrtimi psikiatrik i sistemeve.

### **Historia psikiatrike**

- ❖ Hospitalizimi dhe vizitat në urgjencia psikiatrike për çështje psikiatrike, duke përfshirë çrregullimet e përdorimit të substancave.
- ❖ Trajtimet psikiatrike [lloji, kohëzgjatja, sipas rastit, doza].
- ❖ Respektimi i trajtimeve psikiatrike, duke përfshirë trajtimet psikosociale, farmakoterapinë dhe ndërhyrje të tjera si terapia elektrokonvulsive.

### **Diagnoza dhe simptomet e mëparshme psikiatrike**

- ❖ Halucinacionet [përfshirë halucinacionet urdhëruar], deluzione dhe simptomet negative
- ❖ Idetë ose sjelljet agresive [p.sh., vrasje, dhunë në familje ose në vendin e punës, kërcenime ose akte të tjera agresive fizike ose seksuale].
- ❖ Ide suicidale, plane suicidale dhe përpjekje suicidale, duke përfshirë detajet e çdo përpjekjeje [p.sh., kontekstin, metodën, dëmtimin, suicidin e mundshme, qëllimin].
- ❖ Vetëlëndim i qëllimshëm në të cilin nuk ka pasur qëllim suicidal.
- ❖ Impulsiviteti.

### **Historia e përdorimit të substancave**

- ❖ Përdorimi i duhanit, alkoolit dhe substancave të tjera [p.sh., marihuana, kokaina, heroina, halucinogenët] dhe çdo keqpërdorim i medikamenteve ose suplementeve të përshkruara me ose pa recetë.
- ❖ Çrregullim aktual ose i fundit i përdorimit të substancave ose ndryshim në përdorimin e alkoolit ose substancave të tjera.

### **Historia mjekësore**

- ❖ Nëse pacienti ka apo jo një marrëdhënie të vazhdueshme me një profesionist shëndetësor të kujdesit parësor.
- ❖ Alergjitetë ose ndjeshmëria ndaj medikamenteve.
- ❖ Të gjitha medikamentet që pacienti po merr aktualisht ose ka marrë së fundmi dhe efektet anësore të këtyre medikamenteve [d.m.th., medikamentet me recetë dhe ato pa recetë, suplementet bimore, ushqimore dhe vitaminat].
- ❖ Sëmundjet në të kaluara ose aktuale dhe shtrimet e lidhura me to
- ❖ Trajtimet përkatëse të kaluara ose aktuale, duke përfshirë operacionet, procedurat e tjera ose trajtimet mjekësore plotësuese dhe alternative.
- ❖ Historia seksuale dhe riprodhuese.
- ❖ Statusi kardiopulmonar.
- ❖ Çrregullime ose simptomet neurologjike ose neurokognitive të kaluara ose aktuale.
- ❖ Traumat fizike në të kaluarën, duke përfshirë lëndimet në kokë.
- ❖ Sëmundja endokrinologjike e kaluar ose e tanishme.
- ❖ Sëmundjet infektive të kaluara ose aktuale, duke përfshirë sëmundjet seksualisht të transmetueshme, HIV, tuberkulozin, hepatitin C dhe sëmundjet infektive endemike, sëmundja Lyme.
- ❖ Anomalitë e mëparshme ose të tanishme të gjumit, duke përfshirë apnenë e gjumit

- ❖ Simptomet ose gjendjet e kaluara ose aktuale të shoqëruara me dhimbje dhe parehati të konsiderueshme
- ❖ Rishikim shtesë i sistemeve, siç indikohet.

#### **Historia familjare**

- ❖ Përfshirë historinë e sjelljeve suicidale ose sjelljeve agresive në të afërmit biologjik.
- ❖ Histori personale dhe sociale.
- ❖ Gjuha e preferuar dhe nevoja për një përkthyes.
- ❖ Besimet personale/kulturore, mjedisi sociokulturor dhe shpjegimet kulturore të sëmundjes psikiatrike.
- ❖ Prania e stresorëve psikosocial [p.sh., probleme financiare, strehimore, ligjore, shkollore/profesionale ose ndërpersonale/marrëdhënie; mungesa e mbështetjes sociale; sëmundje të rënda ose terminale].
- ❖ Ekspozimi ndaj traumave fizike, seksuale ose emocionale.
- ❖ Ekspozimi ndaj dhunës ose sjelljes agresive ose abuzimin në fëmijëri.
- ❖ Pasojat ligjore ose disiplinore të sjelljeve agresive në të kaluarën.

#### **Ekzaminimi, përfshirë ekzaminimin e gjendjes mendore**

- ❖ Pamja e përgjithshme dhe gjendja ushqyese.
- ❖ Gjatësi, pesha dhe indeksi i masës trupore.
- ❖ Shenjat vitale
- ❖ Lëkura, duke përfshirë çdo shenjë të traumës, vetëlëndimit ose përdorimit të medikamenteve.
- ❖ Koordinimi dhe ecja.
- ❖ Lëvizjet e pavullnetshme ose anomalitë motorike.
- ❖ Shikimi dhe dëgjimi.
- ❖ Të folurit, duke përfshirë rrjedhshmërinë dhe artikulimin.
- ❖ Disponimi, shkalla e mungesës së shpresës dhe niveli i ankthit.
- ❖ Përbajtja, procesi dhe perceptimet e mendimit, duke përfshirë halucinacionet aktuale, deluzionet, simptomet negative dhe njohuritë.
- ❖ Idetë aktuale për suicid, planet suicidale dhe qëllime suicidale, duke përfshirë mendimet aktive ose pasive për suicid ose vdekje.
- ❖ Nëse janë të pranishme idetë aktuale për suicid, vlerësoni rrjedhën e synuar të veprimit të pacientit nëse simptomet aktuale keqësohen, qasjen në metodat suicidale, duke përfshirë armët e zjarrit, motivimet e mundshme për suicid [p.sh., vëmendja ose reagimi nga të tjerët, hakmarrja, turpi, poshtërimi, faji deluzioni, halucinacionet urdhëruuese], arsyet për të jetuar [p.sh., ndjenja e përgjegjësisë ndaj fëmijëve ose të tjerëve, besimet fetare], cilësin dhe forcën e aleancës terapeutike.
- ❖ Idetë aktuale agresive, duke përfshirë mendimet e agresionit fizik ose seksual ose vrasjes.

Nëse janë të pranishme idetë aktuale agresive, vlerësoni individë ose grupe specifike ndaj të cilëve janë drejtuar idet ose sjelljet suicidale ose agresive në të kaluarën ose në të tashmen, aksesin në armë zjarri dhe impulsivitetin, duke përfshirë çështjet e menaxhimit të zemërimit.

## **4.3 Përdorimi i Matjeve Sasiore**

APA rekomandon [1C] që vlerësimi fillestar psikiatrik i një pacienti me një çrregullim të mundshëm psikotik të përfshijë një matje sasiore për të identifikuar dhe përcaktuar ashpërsinë e simptomeve dhe dëmtimet e funksionimit që mund të jenë fokusi i trajtimit. Në vlerësimin e një pacienti me një çrregullim të mundshëm psikotik, matjet sasiore mund të përdoren gjithashtu për të ndihmuar në zbulimin dhe përcaktimin e ashpërsisë së psikozës dhe simptomeve shoqëruese.

Synimi i përdorimit të një matje sasiore nuk është për të vendosur një diagnozë, por për të plotësuar aspekte të tjera të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit.

Në varësi të matjeve, mund të ndihmohet në planifikimin e trajtimit duke ofruar një mënyrë të strukturuar të përsëritshme për të dokumentuar simptomet bazë të pacientit. Mund të ndihmojë gjithashtu për të përcaktuar se cilat simptome duhet të jenë objektivi i ndërhyrjes në bazë të faktorëve si frekuanca e shfaqjes, madhësia, potenciali për dëmtimin e lidhur me pacientin ose të tjerët, dhe shqetësimi i lidhur me pacientin.

Ndërsa trajtimi vazhdon, përdorimi i matjeve sasiore lejon gjurmimin më të saktë nëse trajtimet jofarmakologjike dhe farmakologjike kanë efektin e tyre të synuar ose nëse nevojitet një ndryshim në planin e trajtimit. Pjesa më e madhe e hulumtimeve të lidhura me trajtimin në psikiatri ka përdorur shkallë të vlerësuara nga klinicistët për të përcaktuar rezultatet e pacientit, megjithatë shkallët e vlerësuara nga pacientët zakonisht kërkojnë më pak kohë për t'u administruar sesa shkallët e vlerësuara nga klinicistët.

Përveç kësaj, ato ofrojnë njohuri të rëndësishme në përvojën e pacientit që mbështesin kujdesin e përqendruar te personi.

Përdorimi i shkallëve të vetë-vlerësuara me kritere për të vlerësuar ashpërsinë dhe shpeshtësinë e simptomeve mund të ndihmojë gjithashtu pacientët të bëhen vetë-vëzhgues më të informuar. Megjithatë, korrelacionet ndërmjet shkallëve të vlerësuara nga pacienti dhe nga klinicistët janë shpesh modeste [Harvey 2011; Spitz et al. 2017], duke sugjeruar që të dy llojet e matjeve sasiore ofrojnë informacion të dobishëm.

Nëse vërehet një mospërputhje në vetëvlerësimin e pacientëve në krahasim me vlerësimet e vëzhguesve të tjerë, kjo mund të sigurojë informacion të rëndësishëm për rezultatet. Saktësia e vetëvlerësimeve të aftësive, performancës ose vendimeve [e quajtur edhe saktësi introspektive] është një parashikues më i mirë i deficiteve funksionale të përditshme sesa matjet objektive të performancës neurokognitive ose sociale [Silberstein dhe Harvey 2019].

## **4.4 Elementet e Planit të Trajtimit**

Në varësi të rrethanave klinike dhe të dhëna nga pacienti dhe të tjerët, një plan trajtimi gjithëpërfshirës dhe i përqendruar te personi zakonisht do të përcaktojë trajtimet që synojnë përmirësimin e funksionimit, reduktimin e simptomeve pozitive, negative dhe adresimin e simptomeve ose çrregullimeve psikiatrike që ndodhin bashkë. Në secilin prej këtyre aspekteve, është thelbësore të merren parasysh qasjet e trajtimit jo-farmakologjik dhe

farmakologjik dhe të pranohet se një kombinim i trajtimeve jofarmakologjike dhe farmakologjike ka të ngjarë të jetë i nevojshëm për të optimizuar rezultatet. Elementë të tjera të planit të trajtimit mund të përfshijnë:

- ❖ Përcaktimin e trajtimit sa më cilësor dhe më të përshtatshëm.
- ❖ Përcaktimin e planeve për trajtimin e rreziqeve të dëmtimit të vetes ose të tjerëve [nëse janë të pranishëm].
- ❖ Adresimin e barrierave për aderim.
- ❖ Angazhimi i anëtarëve të familjes dhe të tjerëve të përfshirë në jetën e pacientit.
- ❖ Ofrimi i informacioneve për pacientët, anëtarët e familjes dhe të tjerëve të përfshirë në jetën e pacientit në lidhje me opzionet e trajtimit, simptomet e hershme të rikthimit, nevojën për monitorim të vazdueshëm, strategjitet e përballimit, shërbimet e menaxhimit të rasteve, komunitetit, duke përfshirë programet e mbështetjes nga kolegët, si dhe qëllimet e trajtimit që lidhen me rrjetet e mbështetjes sociale.
- ❖ Marrëdhëniet ndërpersonale, familjare ose intime.
- ❖ Statusi prindëror.
- ❖ Statusi jetësor.
- ❖ Trauma ose viktimidimi i kaluar.
- ❖ Shkollimi ose punësimi.
- ❖ Konsideratat financiare, duke përfshirë mbështetjen e të ardhurave për aftësi të kufizuar, kur tregohet statusi i sigurimit shendetësor.
- ❖ Përfshirja në sistemin ligjor.
- ❖ Identifikimin e nevojave shtesë historia ose ekzaminimi i gjendjes mendore.
- ❖ Ekzaminim fizik [qoftë nga klinicisti vlerësues ose nga një profesionist tjetër shendetësor], teste laboratorike, imazhe, elektrokardiografi [EKG] ose studime të tjera klinike[ nëse tregohet në bazë të historisë, ekzaminimit dhe trajtimeve të planifikuar], duke bashkëpunuar me mjekë të tjerë [përfshirë ofrimin e kujdesit të integruar] për të shëmangur fragmentimin e përpjekjeve të trajtimit dhe për të siguruar që çrrëgullimet e përdorimit të substancave dhe gjendjet e shëndetit fizik që ndodhin bashkë të menaxhohen.

## V.Trajtimi

### 5.1 Kujdesi Parësor Shëndetësor

Trajtimi optimal i pacientëve me skizofreni kërkon të jetë shumëplanësh. Një plan trajtimi që kombinon terapinë medikamentoze me shërbime dhe terapitë mbështetëse konsiderohet plan i zgjedhur dhe efektiv.

Qëllimet e trajtimit të suksesshëm janë reduktimi i simptomatikës më të fundit, parandalimi i një episodi psikotik në të ardhmen dhe rintegrimi i individit në jetën sociale.

#### Stadet e Trajtimit të Skizofrenisë

**Faza Akute** – qëllimi i trajtimit në këtë fazë është vënia nën kontroll të simptomeve psikotike, në mënyrë që pacienti të mos rrezikojë jetën e tij dhe të tjerëve. Shtrimi në spital, në këtë fazë mund të jetë i indikueshëm, ndërsa përdorimi i medikamenteve konsiderohet si trajtim primar. Dhënia e medikamentit dhe e dozës së duhur ndihmon në reduktimin e ndjeshëm të simptomeve psikotike brenda 6 javëve.

**Faza e Stabilizimit** – gjatë kësaj faze, jo vetëm që arrihet kontrolli i simptomeve psikotike, por disa pacient mund të mbeten me simptome reziduale [negative] apo me simptome minimale të sëmundjes. Qëllimi i trajtimit gjatë kësaj faze është të parandalojë recidivën, të pakësojë simptomet mbetëse dhe të ruajë sa më gjatë gjendjen e stabilizuar.

**Faza Mbajtëse** – faza e përmirësimit afat-gjatë të skizofrenisë njihet edhe si faza mbajtëse e trajtimit. Qëllimi i kësaj faze është të ruajë dhe mbajë nën kontroll simptomet e stabilizuara, të pakësojë rrezikun e recidivave dhe të shtrimeve.

Gjithashtu gjatë kësaj faze punohet përritjen e funksionimit në aktivitetet e jetës së përditshme. Kjo fazë përfshin përdorimin e medikamenteve, terapitë mbështetëse, edukimin dhe këshillimin e familjarëve, si edhe rehabilitimin vokacional dhe psikosocial.

#### Tabloja Klinike e Skizofrenisë

##### *Simptomet karakteristike*

- ❖ Simptomet pozitive: deluzionet, halucinacionet, të folurit e çorganizuar, sjelljet shumë të çorganizuara ose kaotike, përfshirë deviacione e mëdha nga funksionimi normal.
- ❖ Simptomet negative: sheshim emocional, mungesë e të folurit spontan, mungesa e iniciativës që shkakton pakësim të funksionit normal.

##### *Çrregullimi shfaqet në 3 faza:*

- ❖ aktive
- ❖ prodromale
- ❖ reziduale.

Simptomet pozitive janë më të dukshme në fazën aktive të skizofrenisë, ndërsa simptomet negative janë më të dukshme në fazën prodromale dhe atë reziduale.

Pacienti mund të ketë dy ose më shumë simptome, por rëndësi ka që pacienti paraqet shenja të qarta të çrregullimit të mendimit.

## **Etapat e diagnostikimit të skizofrenisë**

Hapat që duhen ndjekur kur një person paraqitet në Institucion/ Qendra që ofrojnë shërbime të Shëndetit Mendor.

### ***Hapi I Vlerësimi i shpejtë i simptomeve psikotike për të përjashtuar shkaqe të tjera të mundshme jo psikiatrike:***

- ❖ Përjashtohet prezenca e një sëmundjeje mjekësore të përgjithshme; dhe
- ❖ Përdorimi i substancave [alkoolit ose drogave].

***Hapi II Marrja e të dhënave anamnestike*** nëpërmjet intervistës së strukturuar klinike dhe observimit të sjelljes së pacientit gjatë intervistës. Mësohet rreth simptomatikës psikotike aktuale, historisë së kaluar psikiatrike, historisë familjare për probleme psikiatrike, historisë për përdorim të medikamenteve apo efekte anësore.

Të dhënat merren nga pacienti, familjarët ose miqtë e tij.

***Hapi III Historia Plotësuese dhe Ekzaminimi Mjekësor:*** mjeku kërkon të dhëna rreth shëndetit fizik, personal dhe sëmundje me karakter hereditar në të afërmën. Pacienti i nënshtronhet një ekzaminimi të hollësishëm fizik, zakonisht përfshin: lëvizjet e syve, ekuilibrin, reflekset, tonusin muskular, etj. Mjeku kërkon ekzaminimin e zemrës [tensioni arterial, pulsi], të mushkërive dhe vlerësimin e temperaturës.

***Hapi IV Testet Laboratorike:*** nuk ka një test specifik për gjetjen dhe konfirmimin e diagnozës së skizofrenisë, por, një analizë e thjeshtë gjaku dhe urine [testi për prezencë substancash] mund të ndihmonte në përjashtimin e ndonjë shkaku tjetër mjekësor. Kërkohen [sipas rastit dhe simptomatikës] ekzaminime të tjera plotësuese si; EEG, MRI dhe/ose CT për të përjashtuar probleme organike trunore si shkaqe të mundshme të simptomeve të ngjashme me skizofreninë.

## **Kriteret Diagnostike të Skizofrenisë sipas DSM-IV**

**A. Simptomet karakteristike:** janë të pranishme dy ose më shumë prej simptomeve të mëposhtme, për një pjesë të rëndësishme të kohës, prej një muajji/më pak nëse është trajtuar më sukses:

- ❖ Deluzione
- ❖ Halucinacione
- ❖ Të folur të çorganizuar [inkohherent]
- ❖ Sjellje e çorganizuar/katatonike
- ❖ Simptome negative [sheshim afekti, alogji, mungesë vullneti]

**B. Disfunkioni shoqëror për të punuar.** Për një periudhë të rëndësishme të kohës një ose më shumë fusha të funksionimit të tillë si: puna, kujdesi për veten, marrëdhëniet personale, janë mjaft të dëmtuara nën nivelin e arritur, para fillimit të sëmundjes.

**C. Kohëzgjatja,** shenjat e vazhdueshme të shqetësimit persistojnë të paktën për 6 muaj. Kjo periudhë duhet të përfshijë të paktën 1 muaj, që plotësojnë kriterin [A] psh., simptome të fazës aktive, dhe periudhat e simptomeve prodromale dhe reziduale.

Gjatë këtyre periudhave shenjat e shqetësimit mund të manifestohen vetëm me simptome negative ose dy ose më shumë simptome të renditura në kriterin [A] [psh., besime të çuditshme dhe përvoja të pazakonshme].

#### **D.Përjashtimi i çrregullimit skizoafektiv dhe çrregullimit të disponimit.**

**E. Përjashtimi i abuzimeve nga substancat ose i sëmundjeve mjekësore të përgjithshme.**

**F. Lidhje me çrregullimet pervasive të zhvillimit [autizmi].**

#### **Nëntipat e Skizofrenisë**

Nënkatgorit të cilat i ndajnë individët skizofrenë në përputhje me simptomet, dekursin klinik dhe përfundimin.

- ❖ *Tipi paranoid*
- ❖ *Tipi çorganizuar*
- ❖ *Tipi katatonik*
- ❖ *Tipi i padiferencuar*
- ❖ *Tipi rezidual*

**Çrregullimi skizofreniform:** i ngjan skizofrenisë sepse simptomet psikotike janë të pranishme, por për një periudhë kohore më pak se 6 muaj, megjithatë mund të mos jetë e dëmtuar veprimtaria shoqërore dhe okupacionale.

**Çrregullimi skizoafektiv me dy nëntipe; depresiv dhe bipolar:** karakterizohet nga prezenca e të paktën të një episodi disponim [episod manikal, depresiv, apo miks] dhe simptomatik të qartë skizofrenike [episode psikotike që plotësojnë kriteret e DSM-IVpër skizofreni]

#### **Trajtimi farmakologjik i skizofrenisë**

Medikamente që përdoren në trajtimin e skizofrenisë quhen antipsikotikë.

Parimet e përgjithshme të përdorimit të antipsikotikëve.

#### **Standartet e përdorimit të antipsikotikëve**

##### **Standardet e Përdorimit të Antipsikotikëve**

| I.   | Çdo pacient duhet të përdor vetëm një antipsikotik, parapëlqehet përdorimi i një doze të vetme [përjashtim bëhet kur kalojmë nga një medikament në medikamentin tjetër]  |
|------|--|
| II.  | Antipsikotikët tipik zakonisht nuk duhen përdorur si sedativ. [Mund të përdoren cikle të shkurtra të benzodiazepinave ose sedativ të përgjithshëm si psh., prometazina].   |
| III. | Dozat duhet të jenë sa më të ulta dhe efektive. Fillimisht aplikohen doza të ulta të mjaftueshme, përpara se të përdoren doza më të larta. Kjo metodë shërben për antipsikotikët tipik ashtu edhe për ata atipik |
| IV.  | Dozat mbi 15 mg në ditë të Haloperidolit ose ekivalente me të, duhet të jenë përjashtim më shumë se sa rregull i praktikës së zakonshme klinike  |
| V.   | Pacientët që marrin doza më të larta dhe për një kohë të mjaftueshme pa treguar ndonjë përmirësim të simptomeve, duhet parë mundësia e përdorimit të Klozapinës  |
| VI.  | Medikamentet antikolinergjike duhen përdorur kundër parkinsonizmit ose distonisë, por duhet tentuar heqja e tyre pas një periudhe 2-3 mujore.  |

Antipsikotikët janë medikamente që përdoren për mjekimin e simptomeve pozitive dhe negative të skizofrenisë.

Ndahen në dy grupe: antipsikotikët e vjetër i referohen përdorimit të disa termave si p.sh., antipsikotikë të gjeneratës së parë, konvencional, tipik, neuroleptik ose trankvilizuesit e mëdhenj.

